




*Agjencia e Lajmeve KosovaPress*



*Komuna e Gjakovës*

# Komuna e Gjakoves dhe Agjencia e Lajmeve "KosovaPress" arrijnë marrëveshje bashkëpunimi si në vijim:

Mars 2018  
Prishtinë

01-41361-5239  
14.03.2018

Institucioni në Kosovë, i interesuar për shfrytëzimin e shërbimeve (të cekura në - Neni 1-) të *A.L KosovaPress, Komuna e Gjakoves* në njëren anë me përfaqësues, z. Ardian Gjini dhe *A.L KosovaPress* përfaqësuar nga Suzana Rakovica nga Prishtina, përgjegjëse e marrëveshjes me autorizim të plotë me datë 13.03.201, lindhin këtë marrëveshje,

## **Neni 1**

### **Lënda e Marrëveshjes**

1.1 Lënda e kësaj marrëveshje është publikimi i banerit të Komunes së Gjakoves lidhur me linkun e ueb faqes, në ueb faqen e Agjencisë së Lajmeve “KosovaPress”.

1.2 Publikimi i komunikatave, konkurseve dhe njofimeve në web faqen e A.L KosovaPress dhe shkrimeve tjera me karakter informativ mbi aktivitetet e përgjithshme të Komunes së Gjakoves.

1.3 Marjen e materialit me video të aktiviteve të Komunes me kërkesë të zyrtarit të informimit dhe publikimi i videove në faqe zyrtare të Komunes se Gjakoves, marjen e materialit deri në dy aktivitete me video në muaj.

## **Neni 2**

### **Detyrimi i palëve**

1.1 KosovaPress detyrohet që gjatë kohëzgjasjes së kësaj marrëveshje dy palëshe ti përgjigjet pozitivisht kërkesave për publikimin e banerit, komunikatave për media dhe aktiviteve me karakter informativ të komunes.

1.2 Komuna e Gjakoves do të bëjë pagesat prej 500€ për një muaj në afat prej pesëmbëdhjetë ditësh nga dita e pranimit të faturës. Faturës duhet t'i bashkangjiten edhe dëshmië e publikimit të banerit, komunikatave për media dhe aktiviteteve tjera me karakter informativ, konform kërkesave të komunes.

## **Neni 3**

### **Zbatimi I marrëveshjes**

1.1 Mënyra dhe kushtet e zbatimit të kësaj marrëveshje mund të përshtaten, kufizohen, modifikohen vetëm me marrëveshje me shkrim nga të dyja palët.

**Neni 4**  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1.1 Në rast të mosmarrëveshjeve eventuale, palët do të lajmërojn njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre dhe për zgjedhje që konsiderohet e mundshme.

1.2 Në rast të paraqitjes së ndonjë mosmarrëveshje ndërmjet palëve gjatë zbatimit të marrëveshjes dhe nëse nuk arrihet zgjidhja mes palëve,mosmarrëveshja do të procedohet në Gjykatën Themelore në Gjakovë.

**Neni 5**  
**Ekzemplarët e marrëveshjes**

1.1 Kjo marrëveshje është përpiluar në dy ekzemplarë të së njëjtës përbajtje ,të nënshkruar në mënyrë të regjult nga palët.

**Neni 6**  
**Hyrja në fuqi**

1.1 Kjo marrëveshje lidhet me kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh. Kjo marrëveshje hyn në fuqi që nga data 12.03.2018 e deri më 12.03.2020.

**Palët nënshkruese**

